



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 35/2018 (JR)
Nr. 35/2 regj.

Tiranë, më 04.07.2019

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se ditën e **mërkurë, në datën 24.07.2019, ora 10:00**, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri 35/2018 datë 23.11.2018, që i përket:

1. Ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 65 datë 13.09.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Ankimit të subjektit të rivlerësimit Valbona Bala (Pajo) kundër vendimit nr. 65 datë 13.09.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjykues
Relatori i Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtar
Gjyqtare

Ina Rama
Sokol Çomo
Albana Shtylla
Luan Daci
Natasha Mulaj

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe nenin 460 pika 5 të Kodit të Procedurës Civile kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE

INA RAMA

